STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 7 nëntor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE ME SHUME SE 320,000 BANORE TE NJU JORKUT (NEW YORKERS) KANE MARE NDIHME NGA PROJEKTI SHPRESA (PROJECT HOPE)

Shërbimet e këshillimit vendimtare ndaj ndihmës për të mbijetuarit e super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrews M. Cuomo) njoftoi sot se më shumë se 320,000 banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) kanë marë shërbimet e Projektit Shpresa (Project Hope), një program i këshillimit të krizave për të mbijetuarit e super stuhisë Sendi (Sandy). Projekti Shpresa (Project Hope), që filloi më pak se një muaj pas prekjes në tokë të super stuhisë Sendi (Sandy), ka qënë një prani e vazhdueshme në zonat e prekura të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) si dhe në qarqet Naso (Nassau), Safolk (Suffolk), Roklënd (Rockland) dhe Uesçestër (Westchester).

"Pas shqetësimeve personale të shkaktuara nga super stuhia Sendi (Sandy), Projekti Shpresa (Project Hope) ka qënë i dobishëm në ndimën për banorët e prekur të Nju Jorkut (New Yorkers) që të përballojnë traumën nga stuhia dhe të shkojnë përpara," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Pasi kaloi stuhia, ky program siguroi ndihmë dhe këshillim për më shumë se 320,000 banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) në një kohë kur kishin nevojë për ndihmë për rimëkëmbje. Pjesa e rimëkëmbjes do të vazhdojë të sigurojë këtë ndihmë dhe të rikthejë shpirtin e qëndrueshëm të Shtetit (State) tonë dhe të të gjithë banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers)."

Projekti Shpresa (Project Hope) është një program këshillimi të krizave i orientuar drejt komunitetit që përqëndrohet kryesisht në ndihmën për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) me kthimin në nivelin e tyre të shëndetit mendor dhe të funksionimit përpara stuhisë. Këshilltarët e krizave sigurojnë këshillim konfidencial, arsim public dhe lidhje me burime aq të nevojshme që ndihmojnë të mbijetuarit që të shkojnë përpara me rindërtimin e jetës së tyre. Ndihma sigurohet në mënyrë konfidenciale dhe pa pagesë në kohën dhe vendin që është i leverdisshëm për të mbijetuarin. Këshilltarët e krizave shkojnë në qendrat e komunitetit dhe vendet e adhurimit, si dhe në shtëpitë private, për t'u takuar dhe për të biseduar me të mbijetuarit e të gjitha moshave.

Projekti Shpresa (Project Hope), i financuar nga Administrata Federale e Administrimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Administration) dhe i administruar nga Administrata Federale për

Abuzimin me Substancat dhe Shërbimet e Kujdesit Mendor (Federal Substance Abuse and Mental Health Services Administration), do të funksionojë deri në shkurt 2014. Projekti Shpresa (Project Hope) është një program i drejtuar nga Zyra e Shtetit të New Yorkut për Shëndetin Mendor (New York State Office of Mental Health), e cila në bashkëpunim me Qarqet e prekura ka kontraktuar më shumë se tridhjetë organizata të shërbimit vendor për të siguruar shërbime të këshillimit dhe ndihmës për individët e prekur nga super stuhia Sendi (Sandy).

Projekti Shpresa (Project Hope) vazhdon të punësojë më shumë se 600 banorë të Nju Jorkut (New York) të pajtuar nga komunitetet ku jetojnë, 518 e të cilëve janë personel i këshillimit të krizave me kohë të plotë me shërbim të drejtpërdrejtë. Në pikun e tij, Projekti Shpresa (Project Hope) punësoi më shumë se 800 banorë të Nju Jorkut (New York) në shërbime të përkohëshme të këshillimit të krizave.

Këshilltarët e krizave të Projektit Shpresa (Project Hope) vazhdojnë të jenë në vijat e para të kësaj katastrofe dhe ishin në shumë raste njerëzit e parë që u ofruan ndihmë të mbijetuarve të super stuhisë Sendi (Sandy). Ata ndihmuan që familjet të kthehen në gjendjen normale, krijuar grupe të ndihmës që do të vazhdojnë të mblidhen në mënyrë të pavarur nga Projekti Shpresa (Project Hope) dhe bënë lidhje me shkollat dhe qendrat e të moshuarve për t'u ofruar shërbime njerëzve më të cënueshëm të shoqërisë sonë. Të gjitha agjencitë e Projektit Shpresa (Project Hope) kanë qënë duke punuar me ofruesit e shërbimeve të komunitetit vendor për të komunikuar programet e ndihmës, trajtimit dhe administrimit të rasteve të komunitetit, të cilat do të mbeten të disponueshme për popullsinë e mbijetuar pas përfundimit të shërbimeve të këshillimit të krizave të Projektit Shpresa (Project Hope).

"Numri i madh i individëve të cilëve u ka shërbyer Projekti Shpresa (Project Hope) është një trashëgimi e vendosmërisë së këshilltarëve të krizave që ishin në pragjet e shtëpive dhe në rrugët e komuniteteve të shkatërruara nga super stuhia Sendi (Sandy). Falënderoj qeverinë tonë dhe partnerët e komunitetit që punuan së bashku për të ndihmuar në lehtësimin e ndikimit të kësaj katastrofe të pashembullt," tha Komisioneri i Përkohëshëm Xhon V. Taurielo (John V. Tauriello), Zyra e Shëndetit Mendor të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Office of Mental Health).

Dr. Adam Karpati, Zëvendës/Komisioneri Ekzekutiv për Higjenën Mendore, Departamenti i Shëndetit dhe Higjenës Mendore të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Health and Mental Hygiene), tha, "Për njerëzit që përjetojnë ende shqetësime një vit më vonë, është e rëndësishme të dine se ndihma është në dispozicion. Ju lutemi lidhuni me Projektin Shpresa (Project Hope) nëse ndjeheni se nuk keni rrugëdalje."

Dr. Xhejms R. Dollën, Jr. (James R. Dolan, Jr.), Drejtor i Shërbimeve të Komunitetit për Shërbimet e Pa-aftësisë së Zhvillimit, Varësisë nga Kimikatet dhe Zyrës së Shëndetit Mendor të Qarkut Naso (Nassau County Office of Mental Health, Chemical Dependency, and Developmental Disabilities Services), tha, "Nën udhëheqjen e Zyrtarit të Qarkut Naso (Nassau) Ed Mangano, Shërbimet e Pa-aftësisë së Zhvillimit, Varësisë nga Kimikatet dhe Zyrës së Shëndetit Mendor të Qarkut Naso (Nassau County Office of Mental Health, Chemical Dependency, and Developmental Disabilities Services),kanë qënë krenare për të patur një partneritet me programin Projekti Shpresa (Project Hope) të Zyrës të Kujdesit Mendor të Shtetit të

Nju Jorkut (New York State Office of Mental Health) në dhënien e shërbimeve të këshillimeve të krizës për ata që u prekën nga super stuhia Sendi (Sandy). Gjithashtu jemi me fat që kemi bashkuar forcat me rrjetin tonë të ofruesve të kujdesit të sjelljes të Qarkut Naso (Nassau) që sigurojnë takime, këshillim dhe lidhje me burimet e komunitetit. Këto përpjekje kanë nxitur qëndrueshmërinë dhe kanë lehtësuar rimëkëmbjen për ata që u ndikuan negativisht nga stuhia."

Art Fleçer (Art Flescher), Drejtor i Shërbimeve të Komunitetit për Departamentin e Shërbimeve të Kujdesit për Qarkun Safolk (Suffolk County Department of Health Services), tha, "Përkushtimi dhe energjia e treguar nga agjencitë tona partnere në zbatimin e iniciativës së këshillimit të krizës të Qarkut Safolk (Suffolk) nga Projekti Shpresa (Project Hope) ka qënë jashtëzakonisht mbresëlënëse. Ndihma në kohë e siguruar për një numër kaq të madh banorësh është një trashëgimi ndaj vlerës së programit dhe nevojës së madhe që u përmbush dhe vazhdon të përmbushet nga këto përpjekje."

Për më shumë informacion në lidhje me Projektin Shpresa (Project Hope), ju lutemi telefononi LifeNet në një nga numrat më poshtë dhe kërkoni Projektin Shpresa (Project Hope). Telefonuesit përputhen me kujdes me agjencinë e tyre të ofrimit të shërbimit për Projektin Shpresa (Project Hope) që e njeh komunitetin e tyre dhe është gati të ndihmojë me rimëkëmbjen e tyre.

Për të kontaktuar LifeNet, ju lutemi telefononi në:
Anglisht: 1-800-543-3638
Spanjisht: 1-877-298-3373
Gjuhët aziatike: 1-877-990-8585

Projekti Shpresa (Project Hope): Numri i individëve të cilëve u është shërbyer sipas llojit të shërbimit (deri më 10/21/13)				
Rajoni	**Takime individuale/familjare të këshillimit të krizave**	**Seanca në grup të këshillimit të krizave**	**Seanca në grup të arsimimit publik**	**Gjithsej**
Qyteti i Nju Jorkut (New York City)	117,396	36,666	42,579	196,641
Qarku Naso (Nassau)	45,404	3,901	19,978	69,283
Qarku Safolk (Suffolk)	29,992	1,322	18,121	49,435
Qarqet Uestçestër/Roklënd (Westchester/Rockland)	1,806	304	3,631	5,741

Gjithsej	**194,598**	**42,193**	**84,309**	**321,100**

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian